



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.630/2 prot.,

Datë 27.03.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54758-12-22-2022, me objekt “Blerje kimikate” me fond limit 49,920,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës

Ankimues: “Albania Distribution Chemicals” SHPK
Rruga e Kavajës, Buka SHA, Nr. 8240, Njesia nr.6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Durrës
L.17 Rr. Dalip Peza, Durrës

Në datën 25.03.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/2980 dhe me nr. 630 prot., datë 27.03.2023 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“OE nuk permbush: 1.Kapaciteti teknik pika 2.3.1 / pasi; nuk përmbush vlerën e punëve të ngjashme prej 40% të fondit limit, sepse nga të gjitha kontratat dhe faturat me sektorin privat të paraqitura nga OE, zera të ngjashëm kapin vlerën vetëm prej 2,672,834 lekësh.

2.Kapaciteti teknik pika 2.3.2 / pasi; nuk ka paraqitur dy punonjësit drejtues mjeti ADR me dokumentacionin e kërkuar. Dhe në deklaratë sipas shtojcës nr.8, ka vetëm një punonjës shofer.

3.Kapaciteti teknik pika 2.4.7/ pasi: OE nuk është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar për të qënë i pranishëm gjatë dërgimit të mostrave për analizim, sipas njoftimit të bërë në sistem.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 27.03.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri